



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2022:046055

Datë: 17.01.2025

Numri i dokumentit: 06722352

**C.nr.154/2022**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË VITI**, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, sipas gjyqtarit Alush Sinani, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.L., me vendbanim në fshatin K. Komuna e V., kundër të paditurit B.A., nga fshati K. Komuna e V., baza e kontestit paditësi për vërtetimin e pronësisë, vlera e kontestit e pa përcaktuar, jashtë seancës gjyqësore, me datë 13.01.2025, bie këtë:

**A K T G J Y K I M**  
**NË BAZË TË POHIMIT**

**I. APROVOHET** si tërësisht e bazuar kërkesëpadia e paditësit B.L., nga fshati K. Komuna e V., **VËRTETOHET** se i njëjti në bazë të shitblerjes dhe mbajtjes së ndërgjegjshme është pronar i ngastrës kadastrale, **P-70101025-00062-0** me sipërfaqe prej 2329m<sup>2</sup>, me kulturë arë, klasa e 4, në vendin e quajtur “Rajishte Tu Vorot” në zonën kadastrale K., e evidentuar në emër të pronarit juridik N.S., gjyshja e të paditurit.

**II.OBLIGOHET i padituri**, që këtë të drejtë t’ia njohë paditësit B.L., të përmbahet dhe të durojë që në bazë të këtij aktgjykimi këtë ngastër ta regjistroj në librat kadastral, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nën pasojën e përmbartimit të dhunshëm.

**III.** Ky Aktgjykim për Zyrën Kadastrale Komunale në Viti, paraqet bazë juridike ta bëjë ndryshimin në regjistra kadastralë, 15 ditë pas plotfuqishmërisë së të njëjtit.

**IV.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

Paditësi B.L., nga fshati K. Komuna e V., ka parashtruar padinë në këtë Gjykatë me datë 09.03.2022, ka kërkuar nga gjykata që t’ia njeh të drejtën e pronësisë në ngastrën kadastrale nr.00062-0, me sipërfaqe prej 2329m<sup>2</sup>, me kulturë arë, klasa e 4, në vendin e quajtur “Rajishte Tu Vorot” në zonën kadastrale K., e evidentuar në emër të pronares juridike N.S., gjyshja e të paditurit.

Paditësi këtë ngaster kadastrale e kishte blerë nga tani i padituri B.A. nga fshati K. Komuna e Vitsë, në vitin 2001, kjo ngaster ne fleten poseduese figuron se pronare juridike është Sallahu, H.Nurija, gjyshja e të paditurit, që do të thotë se paditësi e kishte blerë këtë ngastër nga nipi i pronares juridike, i cili ka qenë edhe posedues faktik i kësaj ngastre, ku menjëherë pas blerjes së kësaj ngastre tani paditësi kishte hyrë në posedim dhe shfrytëzim të menjëhershëm, e që tani më kanë kaluar 21 vite deri në kohën që është paraqitur padia në këtë Gjykatë. Paditësi posa i ka paguar të paditurit çmimin e kontraktuar ka hy në posedim dhe shfrytëzim të ngastres, duke e shfrytëzuar pandërprerë në mënyrë të qetë dhe i pa penguar dhe shqetësuar nga askush, të cilën edhe tani vazhdon ta shfrytëzoj. I padituri nuk e ka rregulluar procedurën trashëgimore, nga se nuk ka pasur interesim, ndërsa pronarja juridike e ngastres ka vdekur ndërkohë, ashtu që deri më tani ngastra në fjalëka mbetur e evidentuar në emrin e pronares fiktive.

Andaj, me qenë se paditësi si posedues i ndërgjegjshëm, e mbanë këtë ngastr në posedim dhe shfrytëzim, tani me padi kërkon nga gjykata që e drejta e pronësisë edhe në aspektin formal t'i njihet atij, në mënyrë që ta realizoj ndonjë të drejtë tjetër mbi këtë paluajtshmëri.

Gjykata të paditurit, B.A. nga fshati K. Komuna e V., konform dispozitave të LPK-së, i ka dorëzuar padinë dhe aktvendimin për përgjigje në padi, ndërsa i padituri brenda afatit ligjor ka dhënë përgjigje në padi.

Në përgjigjen në padi i padituri, ka deklaruar se ngastra si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e ka shitur dhe të njejtën e ka blerë paditësi B.L., i cili edhe e ka paguar çmimin e kontraktuar dhe të njejtën ngastër e ka marrë në posedim dhe shfrytëzim që nga viti 2-001 dhe ka kerkuar që të njejtit të i njihet e drejta e pronësisë po në këtë ngaster 00062-0 me sipërfaqe prej 2329m<sup>2</sup>, me kulturë arë, klasa e 4, në vendin e quajtur “Rajishte Tu Vorot” në zonën kadastrale K., e evidentuar në emër të pronares juridike N.S., gjyshja e tij. Po ashtu i njejtë përgjigjes në padi i'a ka bashkangjitur edhe ekstraktin e leshuar nga Regjistri i Gjendjes Civile në Viti, me datë 11/12/2024, duke e vertetuar se i njejtë është i lindur me datë 03.08.1974, në Viti nga babai Ismajl Aliu nga fshati K. dhe nëna F.A., i martuar, me shtetësi Kosovare, gjithashtu edhe Certifikatën e vdekjes me numër V 10279368 me të cilën vertetohet se Ismajl Aliu, (babai i të paditurit B.A.) kishte vdekur me datë 07.12.2005 në Gjilan.

I padituri përmes përgjigjes në padi ka theksuar se mbi bazat e përmendura më lartë, nuk e kundërshtuar e as kontestuar paditësit kërkesëpadinë dhe të drejtën e pronësisë në ngastrën kontestuese dhe i ka propozuar gjykatës, që të njejtën ngaster paditësit mundësohet dhe ta regjistroj edhe formalisht në regjistrin kadastral, në emër të vet.

Gjykata, pas pohimit të kërkesëpadiës nga ana e të paditurit, konstatoi se kërkesa është e disponueshme për palët, prandaj, në kuptim të nenit 148, paragrafit 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) – me të cilin përcaktohet se “*në qoftë se i padituri deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo tërësisht, gjykata e jep, pa shqyrtim të mëtejshëm, aktgjykimin me të cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesëpadinë (aktgjykimi në bazë të pohimit)*” – vendosi pa shqyrtim të mëtejshëm si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, nga fakti se i padituri e ka pohuar kërkesëpadinë dhe nuk ka kundërshtuar faktet e paraqitura në padi.

Shpenzimet e procedurës janë vendosur konform nenit 452.4 të LPK, pasi që asnjëra palë nuk i ka kërkuar.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL  
2022:046055, 15.01.2025  
C.nr.1542/2022**

Gjyqtari  
Alush Sinani

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimi pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.

Në kuptim të nenit 181 par. 2 të LPK-së, ankesa mund të paraqitet vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore apo nga shkak se deklarata e pohimit është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit.